



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### **SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Lloji i diplomës "Gazetari/ Marketing/ Shkencat e Komunikimit/ Shkenca Politike/ Gjuhë-Letërsi", niveli minimal i diplomës "Master Profesional"**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- 1. Specialist i Komunikimit me Mediat në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit -- Kategoria: III-b**

*Pozicioni i më sipërmë, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL ) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**LËVIZJE PARALELE**

**11/02/2019**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**18/02/2019**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm duke përdorur të gjitha teknikat dhe metodat e komunikimit. Më konkretisht:

1. Komunikon informacionet me interes ndaj medias e publikut, në përputhje me dispozitat ligjore, në mënyrë transparente korrekte e të besueshme.
2. Publikon, përditëson dhe mirëmban web-faqen, faqen në facebook të institucionit me të gjitha informacionet zyrtare, me qëllim informimin dhe transparencën ndaj publikut.
3. Mban lidhje të vazhdueshme me strukturat e informimit publik pranë institucioneve të tjera dhe median. Në rastet e organizimeve të aktiviteteve të Titullarit, njofton dhe mban kontakte me median e shkruar dhe atë elektronike.
4. Planifikon, zhvillon dhe vë në zbatim strategjitë për mardhënien me publikun;
5. Ben kërkime, shkrime dhe shpërndarje te deklaratave për shtyp në mediat e parashikuara.
6. Shkruan dhe redakton , deklaratat për shtyp, broshurat, studimet, fjalimet, artikujt apo raportet vjetore.
7. Përpilon dhe ndjek prodhimin e broshurave, fletpalosjeve, videove promociionale, fotove, etj.
8. Komunikon me publikun, për ofrimin e konsultave dhe këshillimeve për publikun në fushën e veprimit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.
9. Informon publikut me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për ligjin, nxitjen e parimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, duke përfshirë format e disponueshme të mbrojtjes nga diskriminimi.

## LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi ( të vërtetuar me një dokument nga institucioni)
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a- “Master Profesional” ose “Master Shkencor” në Gazetari/ Marketing/ Shkencat e Komunikimit/ Shkenca Politike/ Gjuhë Letërsi.

Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

b- Të kenë të paktën 5- vite përvojë pune në profesion .

c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së (frenjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

#### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

*<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>*

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Kandidati duhet të dorëzojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077 .e- mail: [www.info@kmd.al](mailto:www.info@kmd.al) dokumentat e sipërpërmendur):**

**Dokumentat për procedurën e lëvizjes paralele duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejt brenda datës: 11 / 02/ 2019**

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **13/02/2019**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendën e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të KMD-së, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar* .
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligji nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit ".
- Ligjin nr. 8517, date 22.07.1999 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj.
- Ligji nr. 97/2013 “ Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i vënë për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

*<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>*

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi( [www.kmd.al](http://www.kmd.al)), në stendën e informimit në KMD-së dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

## 2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

### 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a- “Master Profesional” në Gazetari/ Marketing/ Shkencat e Komunikimit/ Shkenca Politike/ Gjuhë Letërsi.

Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

b- Të kenë të paktën 5- vite përvojë pune në profesion .

c- Të kenë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së (frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Kandidati duhet të dorëzoje me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë  
Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077 .e- mail: [www.info@kmd.al](mailto:www.info@kmd.al)  
dokumentat e sipërpërmendur):**

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 18/02/2019**

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 28/02/2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njëjësia e burimeve njerëzore të KMD-së, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar*.
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligji nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Ligjin nr. 8517, date 22.07.1999 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj.
- Ligji nr. 97/2013 “Per mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>



Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” duke filluar nga data **28/02/ 2019**.

## **Njësia Përgjegjëse**